



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

RELACION PËR PAKETËN FISKALE BASHKIA PËRMET 2025

“Qeveritë vendore luajnë një rol kritik në formësimin dhe zhvillimin e jetës shoqërore dhe ekonomike të territoreve të tyre, duke i sjellë komunitetet më pranë njëri-tjetrit dhe duke ofruar zgjidhje vendore për probleme vendore”




**E nderuar Kryetare e Këshillit,
Të nderuar Këshilltarë,**

Ju paraqesim paketën fiskale me nivelet e taksave dhe tarifave vendore për Bashkinë Përmet. Paketa fiskale është dokumenti bazë mbi të cilën mbështetet njëسيا vendore për të kryer aktivitetin e saj lidhur me njohjen dhe vjeljen e të ardhurave. Një paketë fiskale e qartë, e strukturuar siç duhet dhe reale është baza për të planifikuar një buxhet sa më të mirë.

A.1 Procesi i Hartimit të Paketës Fiskale

Për hartimin e paketës fiskale janë angazhuar drejtuesit dhe specialistët e te gjitha Drejtorive që funksionojnë në Bashkinë Përmet.



Dëgjesat Publike me qytetarë dhe grupe interes

Në hartimin e paketës fiskale të Bashkisë Përmet janë përfshirë përfaqësues të komunitetit të biznesit, banorë të njësive administrative, përfaqësues të komunitetit sipas interesit dhe këshilltarë.

Gjate muajit Tetor-Nëntor, propozimet për taksat dhe tarifave vendore janë diskutuar me përfaqësues të komuniteteve të Njësisve Administrative Petran, Piskovë, Çarshovë dhe Frashër. Gjithashtu janë organizuar edhe konsulta me përfaqësues të komunitetit të qytetit, si dhe dëgjesa publike. Pjesëmarrës ishin banorë, kryepaletë e fshatrave si dhe përfaqësues të biznesit të Bashkisë.

Gjatë këtyre takimeve ka patur pyetje, diskutime dhe propozime për përmirësimin e Draftit të Paketës Fiskale, të cilat u morrën parasysh nga ana jonë.

A.2 Cfarë prezanton Paketa Fiskale

Paketa fiskale e vitit 2025 është një rishikim i paketës së vitit të kaluar, tërësia e të cilës nuk është cënuar. Këto rishikime në paketë janë bërë pas takimeve me grupet e interesit dhe bazuar në amendimet ligjore.

Në mënyrë të përmbledhur kjo paketë fiskale synon:

- a) Hartimin e një pakete fiskale të integruar;
- b) Rishikimin e kornizës ligjore me qëllim përcaktimin e saktë të taksave, tarifave dhe çdo pagese tjetër që ndikon në buxhetin vendor dhe për të cilat njësitë vendore duhet të arkëtojnë të ardhura;
- c) Saktësimin e procedurave, afateve, aktorëve, veprimeve, përgjegjësisë për çdo taksë dhe tarifë pjesë e kësaj pakete fiskale. Përcaktimi i saktë i të gjithë elementëve të lidhur me menaxhimin do të pasurojë akoma më tej dhe do të vendosë një bazë të fortë për ndërtimin e një sistemi fiskal eficient dhe transparent.
- d) Përcaktimin e qartë dhe ndarjen në seksione e taksave nga tarifave. Çdo taksë dhe tarifë do të detajohet duke patur në konsideratë elementë:
 - ✓ Taksim i drejtë;
 - ✓ Tarifim mbështetur në kosto;
 - ✓ Klasifikimi i biznesit, qarkullim vjetor, lloji i aktivitetit;
 - ✓ Qartësimi dhe përcaktimi i taksave apo tarifave që aplikohen për kategorinë e familjeve nisur nga lloji, vendndodhja etj;
- h) Analiza e taksave që aplikohen për territorin që mbulon njësitë (mbështetur në legjislacionin në fuqi), përcaktimi dhe detajimi në kategori, unifikimi i kategorive për të gjitha taksat, përcaktimi i bazës së taksueshme dhe aplikimi i kufijve që përcakton ligji;
- i) Rikategorizimi dhe detajimi i taksave;
- j) Analiza e tarifave që aplikohen për territorin që mbulon njësitë (mbështetur në legjislacionin në fuqi), përcaktimi dhe detajimi në kategori, unifikimi i kategorive për të gjitha tarifave, përcaktimi i nivelit të tarifave mbështetur në koston e shërbimit për të cilin vendosen;
- k) Aplikimi i incentivave apo lehtësirave fiskale për grupe të caktuara taksapaguesish në nevojë, sic parashikon ligji.

Vizioni ynë, për një territor bashkiak të integruar, parashikon planifikim dhe investime që krijojnë mundësi për një zhvillim të qëndrueshëm të balancuar për të gjithë territorin, duke mbrojtur burimet natyrore.

Kjo qasje bazohet në përforcimin e identitetit të secilës zonë të Bashkisë, duke patur parasysh burimet natyrore, profilin ekonomik dhe produktet, shtrirjen e shërbimeve dhe traditën, me synimin e përhershëm të rritjes së nivelit të jetesës. Mirëadministrimi i burimeve financiare nëpërmjet planifikimit sa më real të paketës fiskale si dhe zbatimi me rigorozitet i rregulloreve dhe urdhëresave përbën moton e punës tonë. Planifikimin e kemi mbështetur në shpërndarjen sa më të drejtë të ngarkesës tatimore duke bërë përcaktimin e nivelit të tarifës sipas llojit të aktivitetit, sipas vendodhjes gjeografike, duke lehtësuar bizneset në zonat më pak të zhvilluara. Ne synojmë që të kemi në dorë një mekanizëm i cili na ndihmon për të arritur objektivat në realizimin e prioriteteve të identifikuar në planet tona strategjike më afatgjata. Propozimet janë në përputhje edhe me ndryshimet ligjore të ndodhura.

Në Paketën Fiskale të vitit 2025 janë bërë këto ndryshime :

Paketa fiskale është rishikuar me kujdes për të reflektuar një balancë mes nevojave të komunitetit dhe zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm. Ndryshimet janë realizuar pas një procesi gjithëpërfshirës konsultimi me grupet e interesit, duke përfshirë qytetarët, bizneset dhe ekspertët e fushës. Këto përmirësime synojnë të lehtësojnë barrën fiskale për individët dhe bizneset, ndërsa forcojnë bazën financiare për ofrimin e shërbimeve publike cilësore. Ne materialin që ju kemi paraqitur kemi kryer keto rishikime:

1.Në seksionin e Taksave kemi saktësuar piken 2, taksa e ndërtesës dhe përkufizimin sipas VKM nr. 132 datë 07.03.2018 “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksë”, i ndryshuar.

“**Ndërtesë**”, objekti/objektet e ndërtuara mbi/nën sipërfaqen e tokës ose të lidhura me tokën dhe që përfaqëson një strukturë ndërtimore me një ose më shumë njësi pronësore, e cila është objekt i taksës mbi ndërtesën sipas përcaktimit të dhënë në ligj (edhe strukturat provizore).

2.Në seksionin e tarifave vendore te Bashkisë Përmet janë prapozuar ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika DH) Tarifa për subjektet fitues në tendera me seli jashtë territorit të Bashkisë Përmet në paketën aktuale të vitit 2024 ka pasur dy kategori përkatësisht:
Subjekte fitues në tendera me vlerë kontrate 5milionë lekë dhe subjekte fitues në tendera me vlerë kontrate mbi 5 milion lekë ne kemi sygjerruar riklasifikimin sipas grupeve të mëposhtme dhe vlerës tsë tarifës përkatësisht si më poshtë vijon:
 - Subjekte fitues në tëndera me vlerë kontrate deri në 5 milionë lekë tarifa ka qënë 20000 leke/tender propozohet të bëhet 30000 lekë/tender/vit)
 - Subjekte fitues në tendera me vlerë kontrate nga 5 milion lekë-10 milion lekë ka qënë 30000 lekë/tender propozohet të bëhet 50000 lekë/tender/vit

- është shtuar kategoria Subjekte fitues në tendera me vlerë kontrate mbi 10 milion leke në vlerën 70 000 lekë/tender/vit
2. Në pikën E) Tarifë për zënien e hapësirave publike
Sipas paketës fiskale aktuale nuk kemi ndryshuar kategoritë e tarifës së zënies së hapësirave publike për bizneset bar-restorante apo njësi shërbimi por kemi propozuar që për disa kategori të tjera të shohim nivelet e kësaj tarife .
Konkretisht:
- Tarifa për zënien e hapësirës publike për organizim të spektakleve ose panairëve të ndryshme nga 120 lekë/m²/muaj të bëhet 2000 lekë/m²/rast
 - Tarifa për zënien e hapësirës publike nga subjektet me asete si : a) mjete, b) makineri c) bokse d) kabina dh) shtylla e) sonda cpimi etj nga 120 lekë/m²/muaj të bëhet 500 lekë/m²/muaj.
 - Është shtuar kategoria Tarifë për zënien e hapësirës publike nga subjektet me asete si pajisje elektronike në vlerën 150000 lekë/pajisje/vit
 - Është hequr kategoria Tarifë për mbajtjen dhe përdorimin e pajisjeve të mjeteve të lundrimit në lumenj nga subjektet me seli jashtë qytetit Përmet pasi kjo i përket AKZM për administrim sipas ndrysheve të fundit ligjore.

3. Në pikën I) Tarifë Parkimi

Kjo tarifë është rikonceptuar .Aktualisht në paketë ne kishim Parkim në qendrën e qytetit për periudhën prill-gusht niveli i tarifës varionë nga 1-3 orë 50 lekë/mjet dhe mbi 3 orë 200 lekë/mjet ndërkohë që sygjerojmë që periudha të bëhet dhe kategoritë e tarifës :
deri në 1 orë tarifa 100 lekë/mjet
nga 1 -2 orë tarifa 200 lekë/mjet
mbi 3 orë tarifa 300 lekë/mjet

Vendosja e kësaj tarife synon jo vetëm shtimin e të ardhurave por rregullon trafikun në qytet si dhe ndërgjegjeson qytetarët që të lëvisin sa më pak me makina sidomos në periudhën e sezonit turistik që ka dhe fluks turistësh. Bashkia jonë nëpërmjet këtij mekanizmi ndihmon në mbrojtjen e mjedisit e klimës.

4. Pika K) Tarifë për hyrjet në vendet muzeale është propozuar që të përjashtohen nga pagesa fëmijët dhe të rinjtë deri në 18 vjeç ndërsa kategoria tjetër vizitorë vendas e të huaj nga 100 lekë/person të bëhet 200 lekë/person.
5. Pika M) Tarifa për shërbime e aktivitete

Kategoritë:

- Për aktivitete në Pallatin e Sportit ishte 7000 lekë/ora të bëhet 10 000 lekë/ora
- Për aktivitete në Kinema ishte 3 000 lekë/ora të bëhet 5 000 lekë/ora

3.Në seksionin e taksave e tarifave vendore për njësitë Administrative sygjerojmë:

Pika 6 .Tarifë mirëmbajtje e infrastrukturës ujitëse për familjet që përdorin infrastrukturën ujitëse është ndryshuar me rritje nga 200 lekë/familje/vit në 500 lekë/familje /vit.

Sic e dini fokusi ynë në investime ka qënë përmirësimi i infrastrukturës së veprave të kanaleve vaditës në Njësitë Administrative. Investimet kanë qënë të shumta dhe ne sygjerojmë që në fshatrat ku ka përfitues të këtij shërbimi të paguajnë për këtë shërbim. Kjo tarifë është shumë larg kostos por ne sygjerojmë që ky është një zë i rëndësishëm që duhet ti shtohet të ardhurave të bashkisë për të kryer në të ardhmen edhe mirëmbajtjen e tyre.

Zgjerimi i shërbimit të pastrimit dhe në Njësitë Administrative ka qënë sfida jonë. Në bashkëpunim dhe me mbështetjen e Ministrisë së Mjedisit dhe Turizmit kemi përmirësuar ndjeshëm shërbimin e prastimit. Zgjerimi i pastrimit në Njësinë Administrative Petran për fshatrat (Kaludh dhe Qilarisht) dhe për Njësinë Administrative Çarshovë për fshatrat: Çarshovë, Iljarë, Pëllumbar, Tabor.

Në materialin e paketës fiskale kemi paraqitur edhe ndryshimet e strukturave përgjegjese për vjeljen e taksave dhe tarifave sipas zërave kjo bazuar në strukturën e re .

		Ishte	Bëhet/Shtuar
DH	<u>Tarife per subjekte fitues në tendera me seli jashte territorit të Bashkise Përmet(tarifat per pastrim,gjelberim,ndricim)</u>	Fitues ne tendera e investime(me vlera të mëdha)	Fitues ne tendera e investime(me vlera të mëdha)
	-me vlerë kontrate deri në 5 milion lekë	20,000 lekë/tender	30000 lekë/tender/vit
	-me vlerë kontrate nga 5 milion lekë-10 milion lekë	30,000 lekë/tender	50,000 lekë/tender/vit
	-me vlerë kontrate mbi 10 milion lekë		70000 lekë/tender/vit
	P.S Në rastet e bashkimeve të operatorëve kjo tarifë do të llogaritet në raport me vlerën e kontratës të seicilit		
Ë	<u>TARIFE PER ZENIE HAPESIRASH PUBLIKE</u>	Ishte	Behet/Shtuar
	-Organizimi i spektakleve ose panairove të ndryshme	120 lekë /m ² /muaj	2000 lekë /m ² /rast
	-Tarifa për zënie hapësire publike nga subjektet me asete si mjete,makineri,bokse ,kabina,shtylla,sonda çpimi etj.	120 lekë /m ² /muaj	500 lekë /m ² /muaj
	- Tarifa për zënie hapësire publike nga subjektet me asete si paisje elektronike etj.		150 000 lekë/pajisje/vit
I	<u>TARIFE PARKIMI</u>	Ishte	Behet/Shtuar
	-Parkim ne qendren e qytetit per periudhen Mars-Shtator	1-3 ore 50 leke Mbi 3 ore 200 leke	Deri në 1 ore 100 leke/mjet Nga 1-2 orë 200 lekë/mjet

			Mbi 3 ore 300 leke/mjet
K	<u>TARIFË PËR HYRJET NË VENDET MUZEALE</u>		
	Vizitore vendas e të huaj	100 lekë/biletë	200 lekë/ person
	Nxenës e studentë	50 lekë/biletë	
M	<u>TARIFA PËR SHËRBIME E AKTIVITETE</u>		
	Për aktivitete në Pallatin e Sportit	7000 lekë/ora	10 000 lekë/ora
	Për aktivitete në Kinema	3000 lekë/ora	5 000 lekë/ora
	Tarifa në Njësitë Administrative		
6	Tarifë mirëmbajtje e infrastrukturës ujitëse (për familjet që përdorin infrastrukturën ujitëse)	200 leke/familje/vit	500 leke/familje/vit

A.3 Baza ligjore

Në mbështetje të nenit 54, shkronja “f”, të Ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetqeverisjen vendore”, Ligjit Nr. 9632 datë 30.10.2006 ”Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar , Ligjit Nr. 9920 datë 19.5.2008 “Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë “, i ndryshuar,Ligjin nr. 10304, datë 15.7.2010, ”Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin nr.9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar,Ligjin. Nr. 57/2020 “Për pyjet “; Ligjin Nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullosor”, i ndryshuar, Ligjin Nr.10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” , i ndryshuar, VKM nr.559 ,datë 29.07.2022 “ ”Per përcaktimin e tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar,për veprimtari ekonomike,si dhe për prodhimet drusore dhe jo drusore pyjore”,i ndryshuar, Ligjin Nr.10 465, datë 29.9.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”; Ligjin nr. 152/2015, datë 21.12.2015, “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”,VKM Nr.285 datë 27.06.2002 “ Për tarifatat e shërbimeve që kryen policia e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin ndaj shtetasve dhe personave,juridikë e fizikë,vendas e të huaj”,VKM nr.784 datë 09.11.2016” Për mënyrën dhe kriteret e llogaritjes së shpenzimeve të ndërhyrjes për shuarjen e zjarreve në objektet e siguruara administrimin e përdorimin e të ardhurave, për llogaritë shërbimit vendor të MZSH-së”,VKM Nr.632, datë 11.6.2009 “Pë rmiratimin e tarifave

të përdorimit të kullotave dhe livadheve përkullotje dhe kositje” , VKM nr.783 date 10.11.2011 ”Për procedurat e ndarjes së të ardhurave të taksës vjetore të mjeteve të përdorura me njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar dhe Ligjit Nr. 107/2014 datë 31.07.2014” Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, ”, VKM nr.132 datë 07.03.2018 “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike,natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës,si dhe të kritereve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksë” ,Këshilli i Bashkisë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë.

Bazuar në të gjithë sa më sipër, ju paraqesim propozimet tona për sistemin e ri të taksave dhe tarifave që ne duam të zbatojmë për periudhën në vazhdim, duke qenë në linjë dhe në zbatim të prioriteteve të strategjisë së Bashkisë së Përmetit.

Ju faleminderit!

Kryetar i Bashkisë	Alma	HOXHA
Sekretar i Përgjithshëm	Denisa	DURRO
Nënkryetar	Aulona	MESHINI
Nënkryetar	Florand	HASANI
Drejtor i Buxhet- Financë , Burimeve Njerëzore dhe shërb. mbësh.	Etleva	KRECI
Përgjegjës i Buxhet-Financës	Etleva	MYFTARI
Përgjegjës i Tatim-Taksave, Aseteve dhe Liçencave	Dorjan	METKO
Drejtoi i Planifikimit Urban dhe prokurimeve	Laert	BUSHI
Përgjegjës i Pastrim Gjellbërimit	Eftali	LAPAJ
Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve dhe Mirëmbajtjes	Theodhor	ABEDINI
Përgjegjës i MZSH	Fredi	LIPE
Drejtor i Shërbimeve Sociale, Arsimit, Kulturës ,Sporteve	Arjana	PAPAPANO
Përgjegjëse e Qendrës për Fëmijët në Nevojë	Suela	RIZAJ
Përgjegjës i Kulturës dhe Çerdhes	Ledjan	KOMINO
Drejtor i Integritit Europjan ,projekteve dhe Rinise	Klaudja	CIKO
Përgjegjës Sektorit i Pyjeve	Thanas	NIKOLLA
Drejtor i Arsimit Parashkollor	Margarita	TETOLLARI
Përgjegjës i Konviktit	Erald	RAPI
Administrator i Njesisë Administrative Përmet	Kristjana	IBRAHIMI
Administrator i Njesisë Administrative Çarshovë	Ilia	JANI
Administrator i Njesisë Administrative Petran	Ylli	DERVISHI
Administrator i Njesisë Administrative Piskovë	Juxhin	PASHO
Administrator i Njesisë Administrative Frashër	Maringlen	SPAHIU